



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

Nr. 622 Prot.

Fier, më 04.08. 2025

SHPLLJE Nr. 2

E VENDEVE TË LIRA PËR PUNONJËS TË NJËSISË SË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL NË INSTITUCIONET PUBLIK TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (IPAP) NË ZVAP NË VARËSI TË DRAP FIER

Në zbatim të Ligjit nr.69 / 2012 “ Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë“ i ndryshuar, VKM nr.99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e njësive të shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”, i ndryshuar, shpall vendet e lira të punës për punonjës në njësine të shërbimit psiko-social (psikolog/punonjës-social) në institucionet publike të arsimit parauniversitar IPAP, në ZVAP-të në varësi të DRAP Fier.

I. Kriteret për t’u punësuar në shërbimin psiko-social

A. Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
4. Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces penal të hapur në prokurori apo gjykatë;
5. Të mos ketë marrë më parë masë largimi nga punët e mëparshme dhe të mos ketë masa të tjera administrative apo vërejtje në fuqi.

B. Kërkesat e veçanta që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:

1. Kandidati duhet të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
2. Të jetë pajisur me diplomën e ciklit të dytë, në fushën përkatëse;
3. Njohuri bazë në kompjuter;
4. Zotërimi i gjuhëve të huaja përbën avantazh (dëshmi, certifikata);
5. Aftësi komunikuese dhe punë në grup.

II. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

A. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Përshkrimi i edukimit dhe i karrierës profesionale- jetëshkrimin (Curriculum vitae), sipas shtojcës 3 të Urdhërit nr.313, datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
2. Kërkesë për punësim në zyrën arsimore që dëshiron për pozicionin psikolog / punonjës social (e detyrueshme);
3. Raport mjeko-ligjor i tri muajve të fundit (i detyrueshëm);

4. Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumentave të paraqitura nga kandidati sipas shtojcës 4 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
5. Formular vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore sipas shtojcës 5 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 (e detyrueshme);
6. Fotokopje e librezës së punës e noterizuar (nëse ka);
7. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomës/diplomave, vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli i parë, cikli i dytë dhe diplomat e integruara të ciklit të dytë) ose të barazvlefshme me këto sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit (e detyrueshme);
8. Listë notash e noterizuar për nivelin bachelor dhe master (e detyrueshme);
9. Leje për ushtrimin individual të profesionit (licencë);
10. Kopje e njehsuar me origjinalin e arsimit shtesë dhe listës së notave si dhe certifikatave për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
11. Fotokopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale (e detyrueshme);
12. Dëshmi penaliteti (e detyrueshme);
13. Nëse është i punësuar, vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi ose vetëdeklarim në rastin kur nuk është i punësuar (e detyrueshme).

14. Kualifikimi dhe vlerësimi i kandidatëve do të bazohet edhe në kreun VII, pika 4 të Urdhërit nr. 313 datë 20.10.2020, të ndryshuar.

15. Kandidatët që kanë dorëzuar dosje për shpalljen nr1. Dt.16.06 2025 dhe u skualifikuan, të dorëzojnë me postë vetëm kërkesën.

B. Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në DRAP Fier brenda afatit 04.08.2025- 11.08.2025.

- III. Vlerësimi i dokumentacionit të kandidatëve për psikolog /punonjës social do të kryhet nga komisioni në datën 12.08.2025.
- IV. Rezultatet paraprake të vlerësimit të dokumentacionit do të shpallen në faqen zyrtare të DRAP Fier në datë 12.08.2025.
- V. Ankimimet brenda datës 14.08.02.2025.
- VI. Rezultatet përfundimtare do të shpallen në datën 15.08.2025.
- VII. Bazuar në renditjen përfundimtare, DRAP Fier do të ndjekë procedurat e emërimit sipas përcaktimeve të Urdhërit nr.313/2020 i ndryshuar.
- VIII. Vendet e lira sipas ZVAP-ve përkatëse bashkëlidhur.

DREJTORI

Zaira Gjika



LISTA E VENDEVE TË LIRA PËR PROCEDURËN E KONKURIMIT PËR SHPS

04.08.2025

Nr	Drap	Zvap	Shkolla	Psikolog/P/Sc	Kontrata me afat/ pa afat
1	Fier	Fier	Janaq Kilica	P.Social	Pa afat
2	Fier	Fier	Jani Bakalli	P.Social	Pa afat
3	Fier	Fier	Avdi Metaj	P.Social	Pa afat
4	Fier	Fier	Trifon Prifti	P.Social	Pa afat
5	Fier	Fier	Andon Profka	P.Social	Pa afat
6	Fier	Fier	Hiqmet Buzi	P.Social	Pa afat
7	Fier	Patos	Meleq Gosnishti	P.Social	Pa afat
8	Fier	Patos	Muhamet Shehu	Psikolog	Pa afat
9	Fier	Roskovec	Alush Grepcka	Psikolog	Pa afat
10	Fier	Roskovec	7 Deshmoret Strum	Psikolog	Pa afat
11	Fier	Roskovec	5 Deshmoret Suk 1	P.Social	Pa afat
12	Fier	Roskovec	Didin Bishani	P.Social	Pa afat
13	Fier	Mallakastër	Beslidhja	P.Social	Pa afat
14	Fier	Mallakastër	Gjok Doçi	Psikolog	Pa afat
15	Fier	Vlorë-Himarë	Lef Sallata	Psikolog	Pa afat
16	Fier	Vlorë-Himarë	Ali Demi	Psikolog	Pa afat
17	Fier	Vlorë-Himarë	Jani Minga 9-vj	Psikolog	Pa afat
18	Fier	Vlorë-Himarë	Muço Delo	Psikolog	Pa afat
19	Fier	Vlorë-Himarë	Pano Nikolla Memnika	Psikolog	Pa afat
20	Fier	Vlorë-Himarë	Qazim Pali	Psikolog	Pa afat
21	Fier	Selenicë	Qani Nuredini	Psikolog	Pa afat
22	Fier	Selenicë	Eqerem Beqiri	P.Social	Pa afat
23	Fier	Selenicë	Filo Ramdani	Psikolog	Pa afat
24	Fier	Tepelenë-Memaliaj	Nimete Progonati	Psikolog	Pa afat
25	Fier	Përmet-Këlcyrë	Sejfulla Maleshova	Psikolog	Pa afat
26	Fier	Përmet-Këlcyrë	Lumo Pavari	P.Social	Pa afat
27	Fier	Gjirokastrë	Muhamet Gjollështa	Psikolog	Pa afat
28	Fier	Gjirokastrë	Asim Zeneli	Psikolog	Pa afat
29	Fier	Gjirokastrë	Avni Rustemi	P.Social	Pa afat
30	Fier	Sarandë	Adem Sheme	Psikolog	Pa afat
31	Fier	Sarandë	5 Deshmoret	Psikolog	Pa afat
32	Fier	Sarandë	Shefqet Sulejmani	P.Social	Pa afat
33	Fier	Sarandë	Kosta Çavo	Psikolog	Pa afat
34	Fier	Sarandë	Bido Sejko	Psikolog	Pa afat
35	Fier	Finiq-Dropull	Finiq 9vj	Psikolog	Pa afat
36	Fier	Finiq-Dropull	SHB Dervişan	Psikolog	Pa afat
37	Fier	Profesionale	Petro Sota	Psikolog	Me afat